



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**  
**DURRËS**

**Këshilli i Gjykatës**

Nr <sup>23</sup> ..... .Prot.

**Durrës, më datë 10.01.2024**

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN**  
**CIVIL GJYQËSOR**  
**NË KATEGORINË EKZEKUTIVE ARKIVIST**

Në mbështetje të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Vendimit nr 2 datë 09.01.2024 të Këshillit të Gjykatës , shkresës nr 6600/1 Prot datë 28.12.2023 të KLGJ , Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për :

**1 (një) pozicion –ARKIVIST, kategoria IV-2.**

*Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.*

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

**24 Janar 2024**

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

**31 Janar 2024**

## **Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin e Arkivistit është:**

- Arkivisti mban dhe administron dokumentacionin gjyqësor, që përbëhen nga çështjet penale dhe civile, vendimet e të cilave kanë marrë formë të prerë, regjistra dhe akte të tjera gjyqësore që lidhen me veprimtarinë e gjykatës në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për arkivat shtetërore”;
  - Në ushtrimin e përgjegjësive të tij/saj, arkivisti u nënshtrohet akteve ligjore dhe nënligjore në lidhje me mirëmbajtjen e arkivës dhe fondit të arkivës. Arkivisti respekton gjithashtu urdhrat dhe udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit dhe ka përgjegjësi administrative dhe ligjore për mosrespektimin e tyre;
  - Arkivisti garanton që arkivi të jetë i sigurt nga hyrjet e dhunshme, të ketë mbrojtje kundër zjarrit dhe të përmbushë kërkesat teknike të nevojshme për mbrojtjen e arkivit;
- Zyra e arkivit merr masat për të ruajtur dhe trajtuar dosje civile dhe penale, vendimet e të cilave kanë marrë formë të prerë

### **I. LËVIZJA PARALELE**

*Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.*

#### **I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

**Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:**

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a. të jetë diplomuar në nivelin “Bachelor “ . në drejtësi.
- b. Të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

#### **I.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dokumentat si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar
- b. Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik
- c. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- d. Fotokopje të noterizuar librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip
- h. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo me e-mail në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Lagja nr.2, Rruga "Aleksadër Goga ", Durrës nëpërmjet shërbimit postar ose në adresën elektronike: [ZMP.gjykatarrrethitdurrësdures@gjykata.gov.al](mailto:ZMP.gjykatarrrethitdurrësdures@gjykata.gov.al) brenda datës **24.01.2024**

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

*Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.*

### **I.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën **26.01.2024**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të çdo Gjykate, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, *nëpërmjet adresës së e-mail-it*, për shkaqet e moskualifikimit.

### **I.4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Vlerësimi profesional** për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës sipas një sistemi pikëzimi.

**Kandidatët do të vlerësohen:**

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

### **I.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës.

## **II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

*Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës duke filluar nga data 26.01.2024.*

### **II.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA**

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:**

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- të jetë diplomuar në nivelin “Bachelor “ . në drejtësi.
- të ketë përvojë apo njohuri si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

### **II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

- a. Jetëshkrim i plotësuar
- b. Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik
- c. Fotokopje të noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- d. Fotokopje të noterizuar librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- h. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë;

- i. vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- j. Vërtetim nga gjykata;
- k. Vërtetim nga prokuroria.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatë apo me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Lagja nr.2, Rruga "Aleksandër Goga", Durrës nëpërmjet shërbimit postar brenda datës 07.12.2022

### **II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datë 02.02.2024, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim .

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

### **II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

**Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:**

- a. Ligji nr. 98/2016 " Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë,";
- b. Ligji 9154 date 06.11.2003 "Per Arkivat;
- c. Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 " Për rregullat e etikës në Administratën Publike";
- d. Ligji nr.152/2013 " Për nëpunësit civil", i ndryshuar;

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

### **II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen:**

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.

b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

**Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:**

- **Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.**
- **Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.**

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor [www.klgj.al](http://www.klgj.al) dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës duke filluar nga data **01.12.2022**.

➤ *Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të [www.klgj.al](http://www.klgj.al)*